

# Agjencia për Shërbime Mediatike

## Audio dhe Audiovizue

PA1: 05-747/1

26.02.2026

Shkup

Në bazë të nenit 20 paragrafi 1 alineja 10 dhe nenit 18 paragrafi 1 alineja 11, ndërsa në lidhje me nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), nenit 19 të Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/03, 17/11 dhe 154/15 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 122/21) dhe nenit 41 paragrafi 1 alineat 1 dhe 8 si dhe nenit 15 paragrafi 1 alineja 11 të Rregullores për punën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr. 01-3632/1 të datës 22.08.2025, në përputhje me Përfundimin e Këshillit ark. nr. 02-702/3 të datës 26.02.2026, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në seancën e 8-të të mbajtur më 26.02.2026, miratoi këtë:

### Aktvendim

1. Miratohet llogaria vjetore e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale për vitin 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### Arsyetim

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, si një organ rregullator i pavarur dhe i pavarur jofitimprurës me status të personit juridik me autorizime publike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka detyrim të mbajë kontabilitet dhe, pas përfundimit të vitit afarist (që nënkupton vitin kalendarik), të përgatisë llogarinë vjetore. Llogaria vjetore përfshin bilancin e gjendjes, bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve, shënim për shpërndarjen e rezultatit dhe formularët (DB – bilanci tatimor, DE – të dhëna të veçanta për sistemin e evidencës shtetërore për organizatat jofitimprurëse dhe SPD – rekapitulim – struktura e të ardhurave sipas veprimtarive).

Në përputhje me nenin 19 të Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse, llogaria vjetore dorëzohet në Drejtorinë e të Ardhurave Publike dhe në Regjistrin e llogarive vjetore pranë Regjistrit Qendror deri në fund të muajit shkurt të vitit pasues.

Si rrjedhojë e sa më sipër, në bazë të nenit 20 paragrafi 1 alineja 10 dhe nenit 18 paragrafi 1 alineja 11, ndërsa në lidhje me nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, nenit 19 të Ligjit për kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse dhe nenit 41 paragrafi 1 alineat 1 dhe 8 si dhe nenit 15 paragrafi 1 alineja 11 të Rregullores për punën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në përputhje me Përfundimin e Këshillit ark. nr. 02-702/3 të datës 26.02.2026, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në seancën e 8-të të mbajtur më 26.02.2026, mori vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetear i Këshillit,  
Mr. Saho Stefanovski**

Një kopje e vendimit t'u dorëzohet:

- Sektorit për financa dhe logjistikë;
- Sektorit për çështje juridike dhe prokurime publike; dhe
- Sektorit për mbështetje informatike dhe punë të përgjithshme – arkivit të Agjencisë.